

PROCES-VERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“BLERJE VAJRA, GRASO, LITAR PERMISTOPASH DHE KUSHINETA, PËR PAJISJET E STACIONIT TË POMPIMIT”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Vajrave lubrifikuese dhe agjentët lubrifikues - 09211000-1; Graso dhe lubrifikantë - 24951000-5; Kushineta - 44440000-6; Litar - 39541110-0.

VLERA E FONDIT LIMIT PËR OBJEKTIN: “BLERJE VAJRA, GRASO, LITAR PERMISTOPASH DHE KUSHINETA, PËR PAJISJET E STACIONIT TË POMPIMIT”

Fondi limit: “Blerje vajra, graso, litar permistopash dhe kushineta, për pajisjet e stacionit të pompimit”: 1 499 700.00 (një milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) Lekë, **pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës kanalizime Elbasan sha, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetë-deklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formularin e ofertës sipas Shtojcës 1*

ç. *Lista e çmimeve të artikujve sipas Shtojcës 2.*

d. *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë QKB me veprimtari objektin e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në Ligjin 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 77 pika 1, ku shprehimisht thuhet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”, si dhe në VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 40, pika 5/a: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022 ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 20 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet, e shprehur në vlerë .

2.2.3. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 43 pika 2/c, pika 3 dhe pika 4, dhe në nenin 55 pika 4. Kërkesat e renditura sipas kapacitetit ekonomik dhe financiar të përcaktuara në pikën 2.2 i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.4. Vetë-deklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetë-deklarimit, sipas shtojcës 8.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetë-deklorojnë se kanë paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2022, të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetë-deklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, germa d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022, pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari Biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.3 Kapacitetin teknik të operatorëve ekonomikë:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 55 pika 4/b e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.4 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatën e vlefshme:

2.4.1 EN-ISO 9001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalente të saj (të vlefshme).

Certifikata ose ekuivalentja e saj duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga RSH”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë. Certifikata e kërkuara është vlerësuar se lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, dhe konkretisht:- Certifikata S SH EN ISO 9001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të vlefshme, është një provë dhe garanci se operatori ekonomik ofertues ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, nëpërmjet së cilës demonstroi aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte, që plotësojnë standartet më të larta të cilësisë.

2.4.2 Ditën dhe orën e hapjes së Ofertave subjekti Ofertues të paraqesë nga një mostër për të gjithë produktet të cilat duhet të jenë me mbyllje fabrike dhe etiketë fabrike jo etiketë të bërë nga subjekti Ofertues. Në etiketë të jenë të shënuara të gjithë specifikimet teknike të produktit sipas Tabelës në Shtojcën 5, të kërkuar nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021, neni “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 6, “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;”. Me anë të kësaj kërkesë, AK do të sigurohet për cilësinë e artikujve objekt i këtij prokurimi, pasi kanë rol të rëndësishëm në funksionimin e pajisjeve ku do të përdoren, dhe për rritjen e jetëgjatësisë së tyre.

2.4.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin e mallit të kërkuar në objektin e DST pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve, sasisë dhe specifikimeve të përcaktuara sipas Tabelës së Shtojcës 5.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që marrin përsipër realizimin e objektit të kontratës, nëpërmjet transportit me mjetet dhe shpenzimet e tyre, sipas grafikut të lëvrimit të vendosur nga autoriteti kontraktor.

2.4.4 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin mostra për Mallrat e mëposhtëm në ditën dhe orën e hapjes së ofertave.

Nr.	Emërtimi i materialit	Njësia	Sasia	Kriteret e pranimit
1	Vaj SA E 5-40W	litra	1	Vlerësimi i produktit do të jepet pasi të ketë kaluar testin 24 orë, që do bëj AK.
2	Vaj SA E 10-40W	litra	1	Vlerësimi i produktit do të jepet pasi të ketë kaluar testin 24 orë, që do bëj AK.
3	Vaj SA E 20-50W	litra	1	Vlerësimi i produktit do të jepet pasi të ketë kaluar testin 24 orë, që do bëj AK.
4	Graso kundër ujit dhe temperature nga -20° deri + 180°	kg	1	Do të testohet 24 orë nga AK.
5	Litar permistopi ø 16	m/l	1	Paraqitje mostre sipas specifikimeve

6	Litar permistopi ø 14	m/l	1	Paraqitje mostre sipas specifikimeve
7	Litar permistopi ø 18	m/l	1	Paraqitje mostre sipas specifikimeve
8	Kushinetë motori NJ 6322	copë	1	Kushinetat të kenë jo më pak se 6 (gjashtë) muaj garanci nga OE
9	Kushinetë motori 6319	copë	1	Kushinetat të kenë jo më pak se 6 (gjashtë) muaj garanci nga OE
10	Kushinetë motori 6314	copë	1	Kushinetat të kenë jo më pak se 6 (gjashtë) muaj garanci nga OE
11	Kushinetë pompe 6316	copë	1	Kushinetat të kenë jo më pak se 6 (gjashtë) muaj garanci nga OE
12	Kushinetë pompe 6313	copë	1	Kushinetat të kenë jo më pak se 6 (gjashtë) muaj garanci nga OE

Shënim: Mostrat do të paraqiten nga OE, pranë AK ditën e hapjes së ofertave. Mos paraqitja e të gjitha mostrave, apo mospranimi për kryerjen e testeve për artikujt **vaj** dhe **graso**, dhe nuk pranon të lëshojë deklaratë garancie jo më të vogël se 6 (gjashtë) muaj për kushinetat , përbën kusht për s’kualifikim!

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM nr. 285 dt. 19. 05. 2021, neni 40, pika 6/a/b.

“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose fotografitë apo katalogët teknikë”.* Me anë të kësaj kërkesë, AK do të sigurohet për cilësinë e artikujve objekt prokurimi, pasi kanë rol të rëndësishëm në funksionimin e pajisjeve ku do të përdoren, dhe për rritjen e jetëgjatësisë së tyre.

NJËSIA E PROKURIMIT